

VENDIM
Nr.5, datë 6.1.1997

**PËR DHËNIEN ME QIRA TË TRUALLIT KU ËSHTË NDËRTUAR OBJEKTI “VEPRA
SHOQËRORE TË FORMIMIT PROFESIONAL E KULTUROR” NGA NUNCIATURA
APOSTOLIKE E KISHËS KATOLIKE, SHQIPËRI**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie me qira për 49 vjet, pa të drejtë ndryshimi të destinacionit fillestar të ndërtimit, të sipërfaqes prej 5 ha, sipas vendimit të KRRT së Bashkisë së Tiranës, ku është ndërtuar “Vepra shoqërore e formimit profesional e kulturor” nga Nunciatura e Kishës Apostolike, Shqipëri.
 2. Qiraja vjetore të jetë 10 USD për ha.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia e Tiranës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi